



BULETIN JAVOR

29-03 MAJ 2024



PËRMBAJTJA

- Tryeza e Rrumbullakët për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet
- AKCESK zhvilloi CTF e rradhës në Fakultetin e Ekonomisë
- AKCESK pjesëmarrës në edicionin e 4-të "UN-Singapore Cyber Fellowship"
- AKCESK i ftuar në seminarin: "Sigurimi i Infrastrukturave Kritike në Republikën e Moldavisë – nga Mbrojtja te Qëndrueshmëria"

AKCESK zhvilloi CTF e rradhës në Fakultetin e Ekonomisë



Stafi i AKCESK në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, zhvilloi seancën e rradhës të ndërgjegjësimit me studentë të programit të Informatikës-Ekonomike. Përgjatë këtij takimi studentët u njohën me sfidat dhe rreziqet në sigurinë kibernetike, si dhe zhvilluan aftësitë e tyre teknike nëpërmjet një platforme të dedikuar Capture the Flag.

Për të siguruar që kjo nismë të vazhdojë me sukses, do të nënshkruhet gjithashtu një MoU mes AKCESK dhe Fakultetit të Ekonomisë, duke hapur rrugën për më shumë bashkëpunime të ardhshme. Falënderojmë dekanin e Fakultetit të Ekonomisë Prof. Dr. Dhori Kule dhe stafin e departamentit SIZ për mikëpritjen e ngrohtë dhe mbështetjen e tyre në realizimin e këtij aktiviteti.

Tryeza e Rrumbullakët për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet

AKCESK, me mbështetjen e UNICEF, inicioi Tryezën e Rrumbullakët me temë "Bashkëpunimi Ndërinstitucional për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet". Në këtë takim morën pjesë Znj. Nina Guga Zv. Ministër i Arsimit dhe Sportit, Znj. Alma Tandili Kryetare e ASHDMF, përfaqësues nga UNICEF, Policia e Shtetit, Shërbimi Social Shtetëror, Alo 116 111, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Rininë dhe Fëmijët, QPKMR si dhe përfaqësues nga Isigurt.al.

Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, Z. Igli Tafa, njëkohësisht Koordinator Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, parashtroi në këtë tryezë nevojën imediate për të diskutuar rreth rreziqeve të shtuara nga trendet e reja të aplikacioneve dhe masat që institucionet duhet të ndërmarrin bashkërisht për të rritur sigurinë e fëmijëve në internet. Koordinimi ndërinstitucional për të adresuar çështjet e bullizmit në internet dhe nevoja për të ngritur mekanizma efektive për të mbrojtur fëmijët është një nga prioritetet e AKCESK dhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Në këtë tryezë u ndërmorr angazhimi maksimal për të vijuar me hapa konkrete në lidhje me fushata të përbashkëta ndërgjegjësimi si dhe për të kontribuar në përmirësimin e kuadrit ligjor.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.cesk.gov.al



@autoriteti_kombetar_cesk



+355 422 21 039



AKCESK pjesëmarrës në edicionin e 4-të “UN-Singapore Cyber Fellowship”



Në datat 22-27 Prill u zhvillua në Singapor edicioni i 4 i “UN-Singapore Cyber Fellowship”. Ky aktivitet u organizua nga Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike e Singaporit (CSA) në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit (UNODA) dhe Universitetin Kombëtar të Singaporit.

“UN-Singapore Cyber Fellowship” mbledhi së bashku 23 përfaqësues nga Shtetet Anëtare të OKB-së. Në këtë program Shqipëria u përfaqësua nga Drejtori i Qeverisjes së Sigurisë Kibernetike, Riskut dhe Kontrollit në AKCESK, Z.Saimir Kapllani i cili ndau përvojën e Shqipërisë në fushën e sigurisë kibernetike, progresin dhe sfidat që përballemi për krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm kibernetik. Pjesëmarrësit patën mundësinë të ndërveprojnë me agjencitë qeveritare të Singaporit, sektorin privat dhe akademinë, duke shkëmbyer eksperiencat dhe praktikat më të mira për përgjigje të përbashkëta ndaj kërcënimeve kibernetike.

Gjatë këtij programi u diskutuan një sërë temash që përfshijnë fushat operacionale, teknike, politike dhe diplomatike si: përgjigja ndaj incidenteve, mbrojtja e infrastrukturës kritike të informacionit, teknologjitë në zhvillim dhe kuadri i qëndrueshmërisë kibernetike.

Programi kishte gjithashtu një ndërthurje midis leksioneve dhe vizitave në terren si, Laboratorin e Përbashkët NUS-NCS për Sigurinë Kibernetike, iTrust SUTD dhe Qendrën Kombëtare të Integruar për Vlerësim të Universitetit Teknologjik të Nanyangut në Singapor.

AKCESK i ftuar në seminarin: “Sigurimi i Infrastrukturave Kritike në Republikën e Moldavisë – nga Mbrojtja te Qëndrueshmëria”

AKCESK ishte i ftuar në seminarin me tematikë “Sigurimi i Infrastrukturave Kritike në Republikën e Moldavisë – nga Mbrojtja te Qëndrueshmëria” në datën 26 prill në Chisinau, Moldavi mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Moldavisë dhe Misioni i Partneritetit të BE-së në Republikën e Moldavisë.

Seminari adresoi tematika të lidhura me sfidat e sigurisë kibernetike në rajon si dhe ndër të tjera prezantoi kuadrin rregullator të BE-së mbi menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturave kritike të informacionit. Në këtë aktivitet AKCESK ndau përvojën e Republikës së Shqipërisë lidhur me mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit, si një nga shtyllat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe prioriteti i qeverisë për rritjen e nivelit të sigurisë në ekosistemin digjital kombëtar.

Përfaqësuar në panel ishte Z. Eris Sinojmeri, Përgjegjës Sektori i Analizës së Riskut Kibernetik, i cili prezantoi shembullin e vendit tonë lidhur me strategjitë që Autoriteti ndjek për Mbrojtjen Infrastrukturave Kritike të Informacionit.

